REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:028092
Datë: 08.02.2023
Numri i dokumentit: 04026483

2021:028093

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit K.R., nga fshati ..., për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.152/2021, të datës 08.02.2021, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore me datat 17.11.2022, 12.01.2023 dhe 24.01.2023, në prani të prokurorit të shtetit Ardian Emini, të dëmtuarit- dëshmitarit M.R., dhe përfaqësuesit të tij Av. Burhan Qosa, të akuzuarit dhe mbrojtësit te tij me autorizim av. Naim Ferati, më 27.01.2023 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datën. 08.02.2023, përpiloi me shkrim këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari K.R., nga i ati R..., e ëma H..., e gjinisë Z..., i lindur me dt.... në fshatin ..., K Viti, ku dhe tani jeton, numri personal ...., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, i martuar baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij udhëhiqet edhe procedurë tjetër penale.

2021:028093

Ë SH T Ë F A J T O R

Sepse me qellim të shfrytëzimit si origjinal, më 15.11.2018, në Gjykatën Themelore Ferizaj, Divizioni Civil, me dije përdor dokumentin e falsifikuar dhe atë kontratat mbi themelimin e marrëdhënieve të punës të cilat gjoja i ka nënshkruar i dëmtuari M.R., si punëmarrës në njërën anë dhe firma "E.A." SHPK, si punëdhënës, në të cilën kontrata figuron emri i M.R. dhe të pandehurit K.R..

Me këtë ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

Andaj gjykata në bazë të neneve 4 , 7, 8, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 ,74 dhe 398 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),si dhe neni 365, 453 dhe 463 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të akuzuarin e :

GJ Y K O N

Me dënim me gjobë, në shumë prej 3000 /tremijë/ €uro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 46 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 €uro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €uro (njëzet euro), si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 /tridhjetë/ €uro, që të dyja shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari M.R. nga fsh. ...., K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore –juridike udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m i

Historiku i Procedurës

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën e saj PP/II.nr. 152/2021, të datës 08.02.2021, ka ngarkuar të akuzuarin për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj Gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i akuzuari gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajtur shqyrtimet gjyqësore publike, më dt. 17.11.2022, 12.01.2023 dhe 24.01.2023, në prani të prokurorit të Ardian Emini, të dëmtuarit dhe përfaqësuesit të tij Av. Burhan Qosa dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit te tij me autorizim av. Naim Ferati.

Deklarimet e palëve në shqyrtimet gjyqësore

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat dhe detyrimet e tij në kuptim të nenin 323 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, e pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, ka deklaruar se heqë dorë nga leximi i aktakuzës pasi që një kopje të saj e kam pranuar në shqyrtimin fillestar dhe e njëjta në ketë rast edhe më është lexuar nga prokurori e shtetit dhe për ketë nuk kam nevojë të me lexohet pasi që atë e kam të krejtësisht të qartë, gjyqtari i vetëm gjykues pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, konform nenit 325 paragrafi 1 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij për veprën penale për të cilën është akuzuar, si në shqyrtimin fillestar ashtu edhe në atë gjyqësor ka deklaruar se: nuk e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën më ngarkon aktakuza e prokurorit të shtetit, nga se nuk e ndiej veten fajtor, unë jam pronar i disa ndërmarrjeve si "E.A.", "B.K.", "G." e

2021:028093

"A.I." dhe ne kemi rrethe 400 punëtor dhe unë i njoh vetëm inxhinierët dhe menaxherët e ndërmarrjeve, por jo edhe punëtorët, të dëmtuarin e kam takuar vetëm një herë dhe e di që ka qenë punëtor në Kompaninë tonë por nga cila datë nuk e di pasi nuk i mbaj mend datat dhe e di që ai është lënduar në orar të punës në Gjakovë dhe që ka pësuar lëndime trupore dhe për këtë rast sipas padisë se tij është duke u zhvilluar procedurë civile pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, ku unë jam i paditur, unë nuk e di që në shkresat e kësaj lënde që janë dorëzuar dy kontrata pune me të cilat pronari i kompanisë jam unë si punëdhënës ndërsa i dëmtuari është paditës, pasi ne këtë procedurë civile kam pasur të angazhuar Av. Abdylaziz Sadiku nga Gjilani dhe se nënshkrimi në Kontrata nuk është i imi ndërsa vula po dhe kjo që po e them tani është e vërteta dhe nuk qëndron ajo se nënshkrimi në kontrata të jetë i imi pasi që kontratat që janë të përpiluara nga shërbimi juridik i kompanisë i nënshkruan përfaqësuesi i kompanisë i cili ka autorizim. Secila ndërmarrje ka përgjegjësitë dhe sektorët e veta dhe ne kemi edhe shërbimin juridik të cilin e menaxhon juristi I.S. dhe kontratat e punës së firmës "E.A." i nënshkruan menaxheri i kësaj ndërmarrje F.A., me dijen time në kohën kur është lënduar në punë i dëmtuari gjithë punëtorët kanë pasur kontrata pune, duke përfshirë edhe të dëmtuarin M.R. Këtë po e them pasi unë në këtë rast e kam pyetur F.. për të dëmtuarin se a ka pasur kontratë pune dhe i njëjti më ka thënë se po ka pasur kontratë pune. Të gjithë punëtorët kur i kanë marrë pagat e tyre kanë nënshkruar për marrjen e tyre. Ndërsa sa i përket nënshkrimit të kontratës së punës për të dëmtuarit siç kam mësuar nga menaxheri i firmës së cekur ai vetë kontratën e punës e ka nënshkruar por për këtë nuk jam i sigurt.

Provat e prezantuara në shqyrtimet gjyqësore

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), gjykata me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura ka bërë paraqitjen e provave dhe vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura në mes veti, në mbështetje të dispozitës së nenit 361 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, dhe më tej vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar më hollësisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e tillë faktike e ka vërtetuar në bazë të këtyre provave të prezantuara dhe të analizuara në shqyrtimet gjyqësore, konform nenit 8 par.2 të KPPRK-së dhe atë:

2021:028093

- Procesverbali mbi shqyrtimin gjyqësor C.nr.189/17 i dt. 15.11.2018, i përpiluar pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, departamentin civil.
- Dy kontrata pune të cilat janë të përpiluara me datë të njëjtë, gjegjësisht me dt.01.10.2016, e të cilat janë të lidhura në mes të kompanisë "E.A." SHPK dhe M.R.
- Lista e punëtorëve për vitet 2016 dhe 2017.
- Pasqyra e llogaris nga trusti e periudhës kohore nga dt. 20.06.2002 gjerë me dt. 20.06.2018
- Procesverbali i marrjes në pyetje në cilësi të dëmtuarit-dëshmitarit të M.R. në Prokurorinë Themelore në Ferizaj PPN/II .nr. 1026-3/18 i dt. 30.12.2019.
- Procesverbali i marrjes në pyetje në cilësi të pandehurit K.R. në Prokurorinë Themelore në Ferizaj PPN/II .nr. 1026-3/18 e dt. 02.02.2021, si dhe shkresat tjera te lëndes.

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata gjendjen faktike e vërtetoi duke u bazuar nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit M.R., i cili ka deklaruar se në kohën kur kam filluar të punojë te firma "E.A.", pronari i së cilës është i pandehuri, konkretisht në periudhën kohore nga viti 2015 gjerë në ditën e sotme nuk më është ofruar asnjë një lloj dokumenti për të nënshkruar dhe pagesën për punën që e kemi bërë e kemi marrë në para kesh-në dorë dhe atë për çdo 10 ditë pune dhe as një herë nuk ka ndodhur pagesa përmes xhirollogarisë bankare. Me datën 15.11.2018, kur është mbajtur në gjykatë seanca gjyqësore në procedurën civile unë kam qenë prezentë së bashku me përfaqësuesin tim dhe përveç nesh aty kanë qenë prezent edhe i pandehuri K... dhe avokati i tij, në këtë seancë gjyqësore janë prezantuar dokumente që kinse unë kam pasur kontratë punës dhe dokumenti për trustin, e nëse nuk gaboj që më është paguar trusti deri në dhjetor të vitit 2017. Në momentin kur kam shikuar këto dokumente dhe kam parë që nuk është nënshkrimi im kam njoftuar përfaqësuesin tim- avokatin. Nga trusti pensional që lidhet me pasqyrat e kontributeve pensionale nuk më ka ardhur asnjëherë ndonjë pasqyrë e tillë dhe në fund të vitit 2018 pasi që ka filluar seanca gjyqësore në procedurë civile unë kam vërejtur se kam pasur trustin e paguar. Në kohën kur kemi folur për punë me punëdhënësin ata na kanë thënë se rrogën e keni 700 euro, e pastaj pagesën na kanë kthyer në ditë dhe jemi marrë vesh që unë me punua si saldues i certifikuar. Për punën që kam kryer asnjëherë nuk kam nënshkruar ndonjë kontratë pune dhe kontratat të cilat janë prezantuar në gjykatë nuk janë të nënshkruar nga ana ime. Me pronarin e kompanisë K.R., asnjëherë nuk kam biseduar për pagën por kam biseduar me udhëheqësin e grupit të punës që e ka pasur emrin Sh..., dhe për paratë që e kemi marruar në emër të punës që e kemi kryer ditore apo mujore nuk kemi nënshkruar askund.

2021:028093

Me rastin e vlerësimit të provave – dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit M.R., gjykata vlerësoi se i dëmtuari me saktësi ka përshkruar në tërësi rrjedhën se si ka ndodhë ngjarja dhe konstatoi se kjo dëshmi e tij ishte e plotë dhe mjaftë e saktë dhe në përputhje të plotë me provat tjera materiale të paraqitura në këtë çështje penale, siç janë: Procesverbali mbi shqyrtimin gjyqësor C.nr.189/17 i dt. 15.11.2018, i përpiluar pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, departamentin civil, Dy kontrata pune të cilat janë të përpiluara me datë të njëjtë, gjegjësisht me dt.01.10.2016, e të cilat janë të lidhura në mes të kompanisë "E.A." SHPK dhe M.R., e që janë me dy nënshkrime të ndryshme, Lista e punëtorëve për vitet 2016 dhe 2017, Pasqyra e llogaris nga trusti e periudhës kohore nga dt. 20.06.2002 gjerë me dt. 20.06.2018, Procesverbali i marrjes në pyetje në cilësi të dëmtuarit-dëshmitarit të M.R. në Prokurorinë Themelore në Ferizaj PPN/II .nr. 1026-3/18 i dt. 30.12.2019, e pjesërisht edhe me Procesverbalin e marrjes në pyetje në cilësi të pandehurit K.R. në Prokurorinë Themelore në Ferizaj PPN/II .nr. 1026-3/18 e dt. 02.02.2021 si dhe me shkresat tjera të lëndës, prandaj dhe deklaratën e të dëmtuarit gjykata i vlerësoi si mjaft reale, bindëse dhe të besueshme për çka dhe të njëjtës ia fali besimin e plotë dhe nga kjo deklaratë dhe provat tjera si dhe pjesërisht edhe nga deklarimet e vetë akuzuarit u vërtetua fakti mjaft i rëndësishëm dhe i pa kontestueshëm se vepra penale është kryer nga i akuzuari.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit.

Gjykata me vëmendje të veçantë dhe kujdes të shtuar ka vlerësuar dhe analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, por pretendimin e tij dhe të mbrojtësit të tij av.Naim Ferati, se ai nuk e ka kryer këtë vepër penale, gjykata i vlerësoi si jo reale dhe jo të besueshme, pasi që një pretendim i tillë nuk mund të vërtetohej me asnjë provë të vetme bindëse të paraqitur në këtë çështje penale dhe për më tepër pretendimi i tij ishte në kundërthënie të plotë me deklarimin e të dëmtuarit, si dhe me vetë deklarimet e tija (të akuzuarit) i cili pranë kësaj gjykate në shqyrtim gjyqësor në procedurë civile C. Nr. 189/17 të dt. 15.11.2018, ka deklaruar se nënshkrimet dhe vula në Kontrata janë të tijat, ndërsa tani gjatë shqyrtimin gjyqësor në ketë çështje penale juridike pranon se vula është e tij ndërsa mohon se nënshkrimet ne kontrata te jenë të tija duke theksuar se kontratat i përpilojnë dhe i nënshkruajnë personat e autorizuar të kompanisë së tij, këto deklarime tija për gjykatën ishin shumë konfuze dhe deklarimet e tija gjykata i vlerëson se tendencë e i tij për ti ikur përgjegjësisë penale ngase mbrojtja e tij nuk është edhe në përputhje me deklaratën e tij te

2021:028093

dhënë në procedurë civile dhe kjo mbrojte është e pa mbështetshme dhe në kundërthënie të plotë edhe me provat tjera të paraqitura në këtë çështje penale- juridike.

Si të paqëndrueshme vlerësohen edhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se vepra penale nuk është kryer nga i akuzuari, ngase nga veprimet e të akuzuarit të cekura me lartë në rastin konkret, gjykata vlerëson pa asnjë mëdyshje se janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së.

Prandaj duke u bazuar në provat e lartcekura dhe të gjeturat tjera, gjykata thënieve të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij nuk i shprehi aspak besimin, pasi që deklarimet e tilla nuk kanë mundur të provohet me asnjë provë të vetme bindëse, reale dhe të pakontestueshme dhe si të tilla vlerësohen se janë të orientuara krejt në fshehjen e veprimeve inkriminuese të akuzuarit dhe në zvogëlimin e përgjegjësisë së tij penale apo të ikjes nga përgjegjësia penale.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale për çka dhe i akuzuari u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim dhe të elaboruruar me gojë ka theksuar se mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale kundër të pandehurit për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së**,** pasi që pas administrimit të provave gjatë shqyrtimeve gjyqësore, vlerësoj se me pa mëdyshje është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar si në dispozitiv të aktakuzës. Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atë nga dëshmia e të dëmtuarit M.R. i cili ka deklaruar se kishte filluar punën tek firma "E.A." pronar i cili është i pandehuri dhe se nuk i është ofruar asnjë dokument për tu nënshkruar nga punëdhënësi me pronar të pandehurin K.R. dhe se ka qenë prezent në një seancë në procedurë civile dhe se në këtë seancë nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij janë dorëzuar dokumente Gjykatës - kontratë e

2021:028093

punës të cilën i dëmtuari ka shikuar dhe ka vërtetuar se nuk është nënshkrimi i tij, i akuzuari në Gjykatën Themelore Ferizaj - Divizioni civil, në seancën e mbajtur me datë 15.11.2018, kishte pohuar se është nënshkrimi dhe vula e kompanisë së tij në kontratën e punës ku si punëmarrës ka qenë i dëmtuari ndërsa si punëdhënës ka qenë ai dhe kompania e tij "E.A." dhe se këtë dokument e ka përdorur si provë në shqyrtimin kryesor në procedurë civile ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor në procedurën penale ka qenë kontradiktor duke mohuar se nënshkrimet në kontratat e punës nuk janë të tija ndërsa ka pohuar se vula është e kompanisë se tij "E.A." i njëjti ka qenë kontradiktor në deklarimet e tija dhe atë me të vetmin qëllim që të i ik përgjegjësisë penale.

Gjithashtu edhe nga provat tjera materiale si: Procesverbali i hartuar në procedurë civile që mbanë nr.C.nr.189/17 i datës 15.11.2018, e në të cilin procesverbal i pandehuri ka përdorur - prezantuar dokument me dije që ai dokument nuk është i vërtet dhe me qëllim që ta vë gjykatën në lajthim për disa fakte të kontestuara në kontest civil e cila procedurë është duke u zhvilluar në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit si dhe kontratat e punës për kohë të caktuar - të pacaktuar e datës 01.10.2016 si punëdhënës kompania "E.A." SHPK, përfaqësues i pandehuri K.R. dhe punëmarrës i dëmtuari M.R.

Se i pandehuri ka qenë në dijeni se është duke përdorur me dije kontratat e falsifikuara u vërtetua nga rrethana se në dy kontratat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe janë administruara si prova materiale në shqyrtim gjyqësor, gjendet nënshkrimi i të pandehurit të cilat në seancën gjyqësore në procedurën civile që është proces në mes të dëmtuarit si paditës dhe të pandehurit si i paditur i ka pohuar se janë të tijat ndërsa e në shqyrtim gjyqësor ka mohuar se janë nënshkrime të tijat e duke u bazuar në faktin se në dy kontratat e punës gjenden dy nënshkrime të ndryshme e të cilat kanë dallime shumë të mëdha njëra me tjetrën dhe se asnjë nga këto nënshkrime nuk i përkasin të dëmtuarit dhe se nuk është parë e nevojshme që të njëjtat të ekzaminohen.

Andaj mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze, pasi që në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura u vërtetua se i akuzuari është fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, pasi që i njëjti me dije ka përdorur dokumente të falsifikuara dhe se gjoja janë të nënshkruara nga i dëmtuari, e kjo gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se këto dokumente - kontrata asnjëherë nuk janë nënshkruar nga i dëmtuari, i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqiptohet një dënim i paraparë për veprën penale për të cilën akuzohet, gjatë matjes së dënimit

2021:028093

dhe përcaktimit të lartësisë së dënimit për të akuzuarin i propozoj gjykatës që të merr parasysh si rrethanë rënduese rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale pasi që kohën e fundit është duke u shfaqur si dukuri ndërsa si rrethanë lehtësuese nuk u gjet.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuarit M.R. – av.Burhan Qosa në fjalën përfundimtare deklaron se: e mbështes në tërësi fjalën e dorëzuar me shkrim nga prokurori i shtetit, shtoj se tani më është vërtetuar përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës andaj i propozoj gjykatës që konform ligjit ta gjej dhe shpall fajtor për veprën e cila i ngarkohet në aktakuzë.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare deklaron: e përkrahi atë çka deklaroi përfaqësuesi im dhe më tepër nuk kam çka shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit -av.Naim Ferati në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim ka deklaruar: konsideroj se te provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë faktikisht dhe juridikisht vërtetojnë se nuk është provuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës ndaj të pandehurit K.R. Përmes provave të prezantuara vlerësojmë që është vërtetuar fakti që i dëmtuari kishte një kontratë pune nga e cila dhe rrjedhin dhe obligimet e punëdhënësit të tij nga viti 2016-2017 dhe dëshmitë e të dëmtuarit-dëshmitarit të thëna gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk qëndrojnë sepse nuk janë të mbështetura në asnjë provë që do të vërtetonte pretendimet e tilla dhe mbrojtja deklarimet e tija i vlerëson si jo të logjikshme dhe të pa besueshme për faktin që thuhet se nuk kemi nënshkruar asnjëherë, as në momentin e pranimit të pagës. I pandehuri gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka treguar në kompanitë e tij ka të angazhuar rreth 400 punëtorë, si dhe nuk mund ti njoh personalisht punëtorët, përveç inxhinierëve dhe menaxherëve të kompanisë dhe ka treguar se menaxhimin e kompanisë e bëjnë përgjegjësitë dhe sektorët që funksionojnë në kuadër të kompanive dhe sektori për shërbime juridike e menaxhon personi I.S., ndërsa kontratat me të punësuarit në kuadër të kompanisë "E.A." i nënshkruan F.A., i cili është menaxher i kësaj ndërmarrje dhe gjithashtu ka deklaruar sipas dijenisë së tij të gjithë të punësuarit kishin dhe kanë kontrata pune. Ndërsa lidhur me nënshkrimin i cili është në kontratën e punës i njëjti ka deklaruar se ai nënshkrim nuk është i tij dhe nuk e di se kush i ka prezantuar si prova këto kontrata dhe nuk ka pasur dijeni se kontrata në fjalë është nënshkruar nga i dëmtuari apo jo. Akuza ndaj tij është ndërtuar vetëm në bazë të deklaratës së njëanshme të dëmtuarit dhe pa u bërë ndonjë ekspertizë grafologjike që të vërtetohet se nënshkrimet e vendosura në kontratë a janë të falsifikuara dhe të njëjtat nënshkrime të krahasohen edhe me nënshkrimet në dokumentet personale të asaj

2021:028093

kohe. dhe për të vërtetuar se a ekzistojnë dijenia dhe dashja në këtë rast dhe cilat janë pasojat. Andaj bazuar në këtë që u tha më lartë Prokuroria në këtë çështje nuk ka arritur të vërtetoj gjendjen të cilën e ka përshkruar në aktakuzë dhe në asnjë provë nuk ka vërtetuar që dokumenti është falsifikuar apo ndryshuar, andaj dhe propozojmë gjykatës që të pandehurin në mungesë të provave se ka kryer veprën penale ta liroj nga aktakuza.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaron se: e përkrahi në tërësi atë që deklaroi mbrojtësi im dhe më tepër nuk kam çka të shtoj.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë lehtësuese, ndërsa si rrethana rënduese gjeti se i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar me aktgjykime të formës së prerë PKR.nr. 104/16, i dt. 03.07.2007, P.nr. 2023/16 i dt. 21.05.2007 dhe P. nr. 314/18 i dt.. 07.12.2022 dhe përveç kësaj vlerësoi edhe shkallën edhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale dhe bazuar në ketë që u tha më lartë i shqiptoi dënim të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit të paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), ku dhe një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt e në raport me peshën e veprës penale.

Kërkesat pasurore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par. 2 nën par.2.6 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit. Nr. 05/L-036.

2021:028093

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi**.**

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL

2021:028093, e datës 08.02.2023

Zyrtare ligjore	**Gjyqtari i vetëm gjykues**
Kimete Bytyqi	Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.